

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, nëpërmjet Shoqërisë së avokatëve Toshiq dhe Jevtiq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 29.10.2025, e solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll mbi Rába Járműipari Holding Nyrt., shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Martin nr. 1, 9027 Gjer, Hungari, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e dukshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më datë 06.10.2025, dhe plotësuar më 14.10.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) iu dorëzua njoftim për përqendrim nga 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, me të cilin 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag do të fitojë kontroll mbi Rába Járműipari Holding Nyrt., shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Martin nr. 1, 9027 Gjer, Hungari.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag është shoqëri aksionare veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e shoqërive holding, telekomunikimet dhe integrimi i

sistemeve të IT-së, teknologjitë për hapësirë dhe mbrojtje, shërbime radio-difuzive dhe satelitore.

4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag ka një person juridik të lidhur në Maqedoninë e Veriut, dhe ai është Shoqëria për shërbime komunikimi ONE MAKEDONIJA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NUAS:7804148 dhe seli në rr. Crvena Voda numër 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria prioritare e së cilës është 61.20 – veprimtari të telekomunikimeve pa tela.

Rába Járműipari Holding Nyrt. është shoqëri aksionare me aktivitet afarist nga fusha e industrisë së automobilave, me veprimtari kryesore shoqëri holding me më shumë njësi afariste që punojnë në fushën e industrisë së automobilave, gjegjësisht industrisë për prodhimin e automjeteve të ndryshme dhe pjesëve të tyre. Rába Járműipari Holding Nyrt. nuk ka persona të lidhur dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ